

VENDIM
Nr.1, datë 16.1.2012

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË KESH SHA PËR TRANSFERIMIN E
ASETEVE PËRKATËSISHT: “NËNSTACIONI LANABREGAS”, “NËNSTACIONI BOGOVË”,
“NËNSTACIONI GJANÇ”, “NËNSTACIONI BUSHAT 110/20KV”, “ RRJETI 20 KV KOPLIK”,
“NËNSTACIONI SHKODËR 110/20KV”, “NËNSTACIONI FIER 110/20KV”, “NËNSTACIONI
GJIROKASTËR”, “NËNSTACIONI 110/20 KV SARANDË” TEK SHOQËRIA “CEZ
SHPËRNDARJE” SHA

Në mbështetje të neneve 9 dhe 20 pika “1” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 7, 10 pika 1 dhe nenit 11 të rregullores “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin nr.89, datë 13.12.2006 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, pikës 1.3 të licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.1.2012, pasi shqyrtoi kërkesën për miratimin e transferimit të aseteve nga shoqëria KESH sh.a. tek shoqëria “CEZ shpërndarje” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë KESH sh.a. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1.1 dhe 1.2, emri dhe adresa e plotë e të licencuarit (Janë paraqitur në mënyrë të plotë dhe korrekte.).

- Neni 7, pika 1.3, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, përshkrimi i të licencuarit dhe informacioni lidhur me aktivitetin e tij (Ky informacion është dhënë i plotë me të gjitha detajet e kërkuara nga rregullorja.).

- Neni 7, pika 2, 3, 4 dhe 5 (Ky informacion është plotësuar tërësisht.).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë KESH sh.a., “Për transferimin e aseteve, përkatësisht të: “Nënstacionit Lanabregas”, “Nënstacionit Bogovë”, “Nënstacionit Gjanç”, “Nënstacionit Bushat 110/20 kv”, “Rrjetit 20 Kv Koplik”, “Nënstacionit Shkodër 110/20 Kv”, “Nënstacionit Fier 110/20 Kv”, “Nënstacionit Gjirokastër”, “Nënstacionit 110/20 kv Sarandë” tek shoqëria “CEZ shpërndarje” sh.a.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani